



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Për:** Operatorin ekonomik “TOWER” sh.p.k., me nr. NIPT-i L21717003H, me administrator Z. Irdi Kulla, me adresë: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P

**Procedura e prokurimit:** “Kërkesë për propozim”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Mbikqyrja e punimeve të ndërtimeve dhe rikonstruksioneve të rrjetit të Ujësjetllës Kanalizimeve për UKT sh.a. Faza III.

**Loti I:** Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja)” Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33”

**Fondi limit:** 1,380,169 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e SH.A Ujësjetllës-Kanalizime, Tiranë.

**Kohëzgjatja e realizimit të punimeve:** 60 ditë duke nisur nga data e fillimit të punimeve.

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 01/07/2016 Ora: 09:00

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr.25 të dates 27/06/2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “HE & SK 11” sh.p.k. NIPT L19008502B  
Vlera: **570,000** (pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik JV “Ave Consulting” sh.p.k NIPT K81321002M  
& “Sphaera” sh.p.k.  
Vlera: **828,000** (tetëqind e njëzetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “TOWER” sh.p.k. NIPT L21717003H  
Vlera: **1,180,000** (një milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

### Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “HE & SK 11” sh.p.k. me nr. NIPT-i L19008502B me administrator Z.Festim Bregasi, me ofertë ekonomike me vlerë prej 570,000 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, është vlerësuar si ofertë ekonomike anomalisht e ulët.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Në këto kushte nëpunësi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me datën 06.07.2016 i ka dërguar mesazh operatorit ekonomik “HE & SK 11” sh.p.k. në sistemin elektronik me lëndë “Kërkesë për shpjegime për elementë të veçanta të ofertës”,

Shoqëria “HE & SK 11” sh.p.k. ka kthyer përgjigje në sistemin elektronik, me shkresën Nr.104 Prot. Datë 07.07.2016, dhe me shkresën 15350 Prot. Datë 08.07.2016 me lëndë: “Relacion spjegues për elemente të veçanta të ofertës ekonomike.

KVO ka konstatuar se, në detajimin e ofertës O.E ka paraqitur 4 rubrika:

1. Tarifa sipas kategorisë së punës:	Shuma 1	=	308,000 lekë
2. Kostot e drejtpërdrejta:	Shuma 2	=	100,000 lekë
3. Pagesa Ditore:	Shuma 3	=	84,000 lekë
4. Shpenzime të rimbursueshme:	Shuma 4	=	78,000 lekë
	Shuma Totale	=	570,000 lekë

**Nga sa më sipër O.E. “HE & SK 11” sh.p.k. nuk ka parashikuar dhe nuk ka paraqitur një normë fitimi.**

Gjithashtu në detajim nuk janë paraqitur Shpenzime për shtesat mbi pagë (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që mbulon **punëdhënësi**) 16.7%.

Bazuar në Legjislacionin Shqiptar (në zbatim të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për Mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.7703, date 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 77, datë 28.1.2015 për Kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, etj.)etj.

*Punëdhënësi ka detyrimin ligjor të bëjë sigurimin e punëmarësit, me kohë të plotë ose të pjesshme, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute gjatë gjithë kohës, që vazhdojnë marrëdhëniet e punës. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës*

- Referuar Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Neni 13 Detyrimi për të paguar kontributet

1. Kontributet do të paguhen nga personat e siguruar;

2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe **punëdhënësit të tij**, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi;



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J62005002O

3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Sipas detajimit të ofertës së O.E. Shpenzime për pagat e specialistëve =308,000 lekë

Sipas Legjislacionit të sipërcituar, shtojmë rubrikën 5, për Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që mbulon **punëdhënësi** 16.7%.

Shuma 5 =16.7% x 308,000 = 51,436 lekë

Shuma Totale = 308,000+100,000+84,000+78,000+51,436 = 521,436 lekë

Pra shuma totale ndryshon nga vlera e ofertuar nga O.E.

Përfundimi :

- O.E. nuk ka parashikuar Normën e fitimit, ose e ka parashikuar në vlerë 0 (zero), gjë që vë në dyshim cilësinë e shërbimit që do të ofrohet
- O.E. nuk ka parashikuar në shpenzime detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që mbulon punëdhënësi

Për sa më sipër KVO Nuk pranon Argumentin e paraqitur nga O.E. “HE & SK 11” sh.p.k.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik **JV “Ave Consulting” sh.p.k & “Sphaera” sh.p.k.** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 5452 rep. dhe nr.2173 kol., nga shoqëria “Ave Consulting” sh.p.k, me nr. NIPT-i K81321002M, me administrator Z.Arben Dervishaj, me ofertë ekonomike me vlerë prej **828,000** (tetëqind e njëzetë e tetë mijë) lekë pa TVSH, **si pasojë e tërheqjes së ofertës ekonomike të paraqitur prej tij për këtë objekt prokurimi.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“TOWER” sh.p.k.**, me nr. NIPT-i L21717003H, me administrator Z. Irdi Kulla, me adresë: Tiranë, Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P, me ofertë ekonomike me vlerë prej **1,180,000** (një milion e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH., se është **identifikuar si oferta e suksesshme.**



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.07.2016.

Ankesa: nuk ka patur

